



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

Protokoli/Protokol/Protocol Nr.

Lëshuar nga/Puštено od/Released from:
04-11-2025

Përgaditur më/Pripremljenodana/Prepared at:

III- Be prot. 3965 D. 04. 12. 2025

Për/Za/To : z.Smajl Latifi- Kryetar i Komunës së Rahovecit

RAHOVEC - ORAHOVAC

Përmes/Preko/Over:

Nga/Od/From: Besmire Bytyçi, Drejtore e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim

Lënda/Predmet/Subject

Raporti vjetor i punës

Në kuadër të kompetencave dhe detyrave të drejtorisë, për periudhën janar-dhjetor 2025, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka realizuar detyrat e saj konform planit të punës për vitin 2025. Synimet e drejtorisë për punë efikase, përgjigje në kërkesat e qytetarëve në një kohë sa më të shpejtë, bashkëpunim me akterët relevantë për mbrojtje të jetës dhe pronës, intervenim i shpejtë dhe profesional, përmbyllin sukseshëm punën e DMSH dhe NJPZSH.

- Gjatë periudhës Janar-Nëntor, janë inspektuar lumenjtë, përrockat dhe kanalet e hapura në të gjithë territorin e Komunës, inspektimi i tillë specifikisht në pikat kyqe ku situatë shihet më e rënduar bëhet disa herë në vit në mënyrë që të eliminohet rreziku për vërshime. Pas incizimit të gjendjes në terren i kemi propozuar drejtorive përkatëse trajtim në ato vende ku ka pasur nevojë për ndërhyrje.
- Kemi bërë Inspektimin e rregullt të objekteve publike, private dhe shëndetësore për verifikimin e gjendjes së aparateve për shuarjen e zjarreve.
- Është kryer servisi i parë për vitin 2025 i aparateve për fikjen e zjarrit në 70 objekte publike të komunës, janë servisuar gjithsej 558 aparate të vendosura në këto objekte. Në objektet e Komunës së Rahovecit dhe zyreve të administratës publike në të gjithë territorin e Komunës, në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, çerdhe, QKMF dhe QMF-të, Shtëpitë e Kulturës, muzetë dhe në palestrën e sporteve.
- Inspektori për parandalim ka pasur 11 verifikime për dhënien e pëlqimit për mbrojtje nga zjarri për ndërtimin e objekteve dhe 18 dalje për verifikimin dhe hulumtimin e shkaqeve të zjarreve të ndodhura.

- Këtë vit, janë hartuar dy dokumente të rëndësishme:
 - Dokumenti mbi rreziqet dhe masat e sigurisë për muajt Korrik dhe Gusht, në të cilën periudhë rreziku për zjarre është tejte i madh si pasojë e temperaturave të larta.
 - Dokumenti për Ngritjen e Gatishmërisë Emergjente për muajt Korrik dhe Gusht për vitin 2025, me të dhënat e dala nga ky dokument synojmë reagim të shpejtë të NJPZSH-së në mbrojtje të pronës dhe jetës dhe minimizimin e dëmeve që mund të shkaktohen.
- Është formuar grupi punës për hartimin e Planit Operativ Emergjent, në grupin punës janë të përfshirë të gjithë akterët të cilët në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, mund të kontribuojnë për ti ndihmuar qytetarët dhe minimizuar dëmet që mund të na shkaktohen.
- Është kryer servisi i dytë për vitin 2025 i aparateve për fikjen e zjarrit në 70 objekte publike të komunës, janë servisuar gjithsej 558 aparate të vendosura në këto objekte: Në objektet e Komunës së Rahovecit dhe zyreve të administratës publike në të gjithë territorin e Komunës, në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, çerdhe, QKMF dhe QMF-të, Shtëpitë e Kulturës, muzetë dhe në palestrën e sporteve.
- Komisioni komunal për vlerësim të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, kanë vlerësuar 345 kërkesa për vlerësim të dëmeve, kryesisht në kultura bujqësore dhe sera.
- Në fillim të muajt dhjetor, ka filluar puna në renovimin e objektit të zjarrfikësve dhe oborrit në të cilin gjendet objekti, ky projekt parashihet të përfundohet në fund të muajt dhjetor.
- **Fusha 6 - Menagjimi i fatkeqësive, Indikatorët e performancës,**
 - Niveli i realizimit të planit komunal për Reagim Emergjent, çdo fatkeqësi natyrore e cila është me rrezikshëmri të lartë, aktivizohet Plan i Reagimit Emergjent Komunal, në të cilin plan janë të detajuara detyrat dhe përgjegjësitë të çdo institucioni që vepron në komunë.
 - Intervenimet për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të gjitha këto informata janë nga NJPZSH-Rahovec, poashtu me këto të dhëna janë të informuar edhe AME-MPB. Për çdo muaj këto informata përcillen në këto institucione.

- Muajt e verës u karakterizuan me temperatura jashtëzakonisht të larta, gjatë këtyre muajve në territorin e komunës sonë u shënuan 278 zjarre, kryesisht hamullore.

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe int.tjera janar-dhjetor 2025														
2025	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rejsh	Të lënduar			Të vdekur			Githsejt
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot	
Janar	25	14	2	6	2	0	1	0	2	2	0	0	0	25
Shkurt	14	10	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	14
Mars	33	24	1	8	1	1	0	0	0	0	0	1	1	33
Prill	16	5	1	8	0	1	1	0	0	0	0	0	0	16
Maj	21	2	5	10	4	0	0	0	0	0	0	0	0	21
Qershor	35	27	1	4	0	0	2	0	0	0	0	0	0	35
Korrik	84	76	1	2	1	0	3	0	0	0	0	0	0	84
Gusht	90	76	2	11	1	0	1	0	0	0	0	0	0	90
Shtator	45	27	1	14	1	0	2	0	0	0	0	2	2	45
Tetor	23	16	0	5	1	0	1	0	0	0	0	0	0	23
Nëntor	14	1	1	3	0	8	1	0	0	0	0	0	0	14
Dhjetor														

Drejtore për Mbrojtje dhe Shpëtim

